

VENDIM
Nr. 656, datë 8.10.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I
PROJEKTIT “FURNIZIMI ME UJË DHE SHËRBIMET SANITARE NË ORIKUM”**

(ndryshuar me VKM nr. 559, datë 18.6.2015)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Furnizimi me ujë dhe shërbimet sanitare në Orikum”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës - Kanalizimeve.

3. *Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për tokë “pemishte”, “ullishte” dhe “truall” me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 7 860 619.8 (shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë pikë tetë) lekë.*

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 7 860 619.8 (shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë pikë tetë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2014, për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, programi “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, zëri “Kosto lokale”, parashikuar për Njësinë e Menaxhimit të Projekteve (PMU).

5. *Shpenzimet procedurale, në vlerën 183 000 (njëqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjellës – Kana-lizimeve.*

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës - Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjellës - Kanalizimeve të kryejë likuidimet për efekt shpronësimi në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës - Kanalizimeve të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjellës - Kanalizimeve, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjellës - Kanalizimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "FURNIZIMI ME UJË DHE SHËRBIMET
SANITARE" NË ORIKUM

Nr.	Emër, atësia, mbiemri	Zona/kad	Nr.pasurie	Sip.në m ²	Lloji i pasurisë	Çmimi	Vlera	Shënime
1	Bashkëpronësi Avdi Nika	3140	141/2	77	Pemishte	327	25179	Konfirmim
2	Petref Lameborshi	3140	67/2	68	Tokë Ullishte	327	22236	Konfirmim
	Totali i sipërfaqes për shpronësim			145		654	47415	

(shtuar me VKM nr. 559, datë 18.6.2015)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME UJËSJELLËS KANALIZIME

Lista e Pasurive që Shpronësohen nga zbatimi i Projektit "Furnizimi me Ujë dhe Shërbimet Sanitare ne Orikum"

Nr	Emër, atësia, mbiemri	Zona/ Kad	Nr. Pasurie	Sip. shpronës.m ²	Lloji i pasurisë	Çmimi lek/m ²	Vlera	Shënime
1	Bashkëpronësi GJIKOKA	2832	126/104	580.5	Truall	7044	4089042	Konfirmuar ZVRPP
2	Bashkëpronësi MEHILLAJ	2832	2/ 15.	528.7	Truall	7044	3724162.8	Proces.konfirmimi
	SHUMA			1109.2			7813204.8	